ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)*

Sa i përket tenderit për *(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Tulla Studio SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ulpiana E-32, rr. Imzot Nikeprelaj nr. 69/4
(Adresa)

Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 162 639 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Muhamet Uka
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info@tullastudio.com
(Adresa elektronike)

20.05.2022
(Data e parashtrimit të ankesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Titulli: **Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore të Gjilan Dega në Viti**
Data e përgatitjes së dosjes së konkursit projektues: **09.03.2022**
Njoftimi nga AK: **05.05.2022**
Kerkesa per rishqyrtim dt. 10.05.2022
Vendimi i AK mbi Pezullimin e Aktivitetit te Prokurimit dt. 11.05.2022
Vendimi i AK i dt. 12.05.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [×] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesa per rishqyrtim dt. 10.05.2022

Kemi kerkuar te kemi çasje ne Vendimin e Jurise per te pare kriteret, nenkriteret dhe sistemin e pikeve te vleresimit mirepo nuk na eshte lejuar nga AK sepse te njejtit na rekomanduan qe te bejme ankesen ne OSHP me pretendimin se vetem KRPP, OSHP ose ndonje Gjykate kompetente, kane te drejte te kene qasje ne Vendimin e Jurise ku mund te shihen kriteret, nenkriteret dhe sistemi i pikeve te vleresimit.

Na eshte lejuar vetem shikimi i Projektit Ideor te vleresuar si me i miri.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ne Vendimin nr. Ref/ZP/088/2022, te dt. 12.05.2022, **nuk** ka lejuar çasje ne Vendimin e Jurise ku mund te shihen kriteret, nenkriteret dhe sistemi i pikeve te vleresimit te Koncept Projekteve, me arsyetim se eshte bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik, Neni 80, pika 5 i cili qarte thekson se Anetaret e Jurise nuk guxojne ta zbulojne permbajtjen e diskutimeve para nje personi tjeter qe nuk eshte anetar i jurise ndersa NUK e ndalon AK qe pjesemarresit ne konkurs te kene te drejten e çasjes ne Vlersimin e Jurise, sipas Nenit 10, pika 5.

Neni 10, pika 5 Autoriteti kontraktues , me kërkesë të një personi ose pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë personit ose palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin personi ose pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 80, pika 3 Kriteret për shpërblim të cilat përdoren për konkurs projektimi janë obliguese vetëm me **kritere matëse** dhe peshat të paraqiten në aspekte monetare kurdo që është e mundur dhe nuk kufizohen me kriteret e përmendura ne paragrafin 3. të nenit 52, pasi që edhe kriteret që ndërlidhen me vlera artistike mund te merren parasysh. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen dhe

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pasi qe AK nuk na mundesoi çasjen ne kriteret, nenkriteret dhe sistemin e pikeve te vleresimit te Jurise, ne u detyruam qe ta vleresojme vetem projektin e perzgjedhur si oferta me numrin me te madh te poenave. Pasi e analizuam projektin ne fjale verejtem nje mori shkeljesh te rregullave baze te projektimit, mosperputhje me kerkesat e konkursit te projektimit dhe shkelje e rregullave te manualit "Standardet per Dizajnimin e Ndertesave te reja te Gjykatave ne Kosove" - Keshilli Gjyqesor i Kosoves.
Ne vijim po i paraqesim disa nga keto shkelje dhe mos perputhje me kerkesat ne dosjen e konkursit:

1. Sallat e gjykimit jane te projektuara gabimisht sepse:
   - zona e procesit gjyqesor nuk eshte e ndare me zonen e publikut
   - nuk eshte i projektuar vendi per procesmbajtesin
   - nuk kane kthinen per Keshillim/Votim te panelit te gjyqtareve
   - te kthinat per perkthyes kane qasje publiku
2. Zyra e Ndihmes Administratorit eshte e projektuar gabimisht sepse duhet te jete ne afersi te zyres per menagjimi e lendeve dhe te kete çasje direkte ne te.
3. Standardet e projektimit per persona me aftesi te kufizuara, nuk jane marre parasysh:
   - Rampat e projektuara ne hyrje te nderteses kane renie shume te madhe (mbi 15 %) dhe duhet te jete me se shumti 8%
   - Dimensonet e tualeteve jane 180x153 cm, qe eshte nen çdo standard te projektimit.
   - Jane te projektuara vetem ne katin perdhese dhe jo ne katet tjera ku punojne stafi i gjykates dhe
   - ne sallat e gjykimit nuk jane parapare vendet per keta persona
   - korridoret jane te projektuara me gjeresi 120 cm qe eshte nen minimum
4. Zyra per mbeshtetje ligjore eshte projektuar ne katin perdhese e duhet te jene ne afersi te zyreve te gjyqtareve dhe te sallave te gjykimit

Ndersa disa nga mosperputhjet me kerkesat e dosjes se konkursit jane:

1. Ne perdhese mungon bufeja
2. Ne zyren e mbeshtetjes ligjore jane parapare 10 vende pune kurse ne dosje te te konkursit kerkohen 3 kthina te veçanta:
   - 1 zyre per bashkepunetore profesional me 4 persona
   - 1 zyre per perkthyes me 2 persona dhe
   - 2 kthina nga 8 persona.
3. Nuk jane parapare kthinat per Shefat e zyreve ashtu sic kerkohet ne dosje (te kerkesat funksionale)
4. Mungon zyra per bashkepunetore profesional
5. Mungon zyra per perkthyes

Ne fund duam te theksojme qe Koncept Projekti ka mungese te harmonizimit te hapesirave sepse autori ka mbushur hapesirat qe i kane tepruar me kthina shtese te cilat nuk kerkohen ne dosje te konkursit si:

- Salle shtese per mbledhje
- Kthina per sigurim
- Kthina per depo
- Kthina per material harxhues
- Kthina teknike
- Kthina shtese per njesine e paraburgimit ku dyert hapen brenda, qe nuk lejohet si dhe njera nga to ka tavoline dhe karrige brenda qe poashtu nuk lejohet

Kurse mungojne hapesirat e kerkuara ne dosje te konkursit si ne paragrafin me larte.
Paramasa dhe parallogaria eshte shume siperfaqesore
Parkingu per publik mungon perkunder hapesires se madhe qe ofron parcela

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojme se me vleresimin jo te drejte te komisionit vleresues i cili nuk ka qene ne perberje me 2/3 e profesionisteve (ne kete rast arkitekteve) siç kerkohet me ligjin e Prokurimit Publik nr. 04/L-042, Nenin 80 pika 1, jemi eliminuar pa te drejte nga konkurrenca dhe pa te drejte eshte rekomanduar OE i cili nuk i ploteson kushtet as per se afermi me ato se cfare eshte kerkuar ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit.
Projekti Ideor me te cilin kemi konkuruar i ploteson te gjitha kushtet sipas specifikimit teknik dhe sipas: STANDARDET PER NDERTESAT E REJA TE GJYKATAVE ne Republiken e Kosoves.
Kerkojme nga OSHP qe te nxjerr:

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar Ankesa
II. II. ANULOHET Vendimi i datës 05.05.2022 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*